



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 77, Datë 22.04.2020

MBI

**KËRKESËN E ZYRTARIT TË PËRPUTHSHMËRISË SË ALBGAZ SH.A.
PËR SHTYRJEN E AFATIT TË DORËZIMIT TË RAPORTIT VJETOR TË
PËRPUTHSHMËRISË SË OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT TË
GAZIT NATYROR**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar; nenit 47 të ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, i ndryshuar, nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, kreut VI, gërma C, pika 73, të “Programit të përputhshmërisë të operatorit të sistemit të transmetimit për gazin natyror”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 77, datë 26.05.2017, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.04.2020, mbasi shqyrtoi Informacionin e përgatitur nga Drejtoria Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e zyrtarit të përputhshmërisë së Albgaz sh.a. për shtyrjen e afatit të dorëzimit të raportit vjetor të përputhshmërisë”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 77, datë 26.05.2017 “Mbi miratimin e programit të përputhshmërisë së operatorit të sistemit të transmetimit për gazin natyror” ka vendosur të miratojë Programin e Përputhshmërisë së operatorit të sistemit të transmetimit për gazin natyror (RCP).
- Në kreun VI, gërma C, pika 73, të këtij programi, përcaktohet si vijon: *1. Çdo vit, jo më vonë se data [31 Mars], Zyrtari i Përputhshmërisë duhet të përgatisë dhe dorëzojë në ERE një raport për përputhshmërinë e OST me këtë Program, i cili duhet të publikohet në faqen e internetit të OST dhe të ERE.*
- Me komunikimin elektronik të datës 08.04.2020, Zyrtari i Përputhshmërisë së ALBGAZ sh.a., ka bërë me dije se në kushtet kur, Qeveria Shqiptare, me anë të Vendimit nr. 243, datë 24.03.2020, ka vendosur “Shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në të gjithë Republikën e Shqipërisë për shkak të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19”, si dhe pas masave të mara për kufizimin e lëvizjes, ka rezultuar i pamundur verifikimi i të dhënave,

rishikimi i korrespondecave si dhe përditësimi i informacionit për përfundimin e Raportit Vjetor të Përputhshmërisë për vitin 2019 për ALBGAZ sh.a..

- Duke marrë në konsideratë gjendjen e krijuar për shkak të COVID-19 dhe kufizimet që janë vendosur me qëllim parandalimin e përhapjes së këtij infeksioni, kërkesa e Zyrtarit të Përputhshmërisë për të shtyrë afatin e dërgimit të Raportit Vjetor deri jo më vonë se 1 muaj pas përfundimit të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19, është e drejtë dhe në harmoni me vendimmarrjet e ERE nr. 51 datë 26.03.2020 si dhe nr. 67 datë 08.04.2020, mbi masat e përkohëshme për trajtimin e çështjeve në kompetencë të ERE-s pas përfundimit të gjendjes së fatkeqësisë natyrore.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të pezullojë zbatimin e afatit të parashikuar në kreun VI, gërma C, pika 73, të Programit të Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror, miratuar me vendimin e bordit të ERE Nr. 77, datë 26.05.2017, deri jo më vonë se 30 ditë pas përfundimit të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë Zyrtarin e Përputhshmërië së Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Gazit Natyror, Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë si dhe OST sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE

Petrit AHMETI